



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
**BASHKIA SHKODËR**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË**  
**04.08.2025**

Me datë 04.08.2025, u mbajt mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Edmond Ndou, Jona Leqejza, Bledianë Nika, Uarda Gjekaj, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Erald Erkocaj, Armela Brahimi, Ardit Taflaj, Hedije Nasa, Alma Mehmetaj, Erlinda Kavaja, Taulant Shahmani, Gjovalin Ndoj, Jurgena Braçaj, Florian Bjanku, Irena Shala, Izmira Rusi, Valjeta Bajraktari, Eliona Shkrela, Ardit Behri, Gjenarin Kapçari, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Ervin Brahimi, Marina Duhani, Ardita Spahija, Suada Kopshti, Vjoleta Përndreçaj, Fatmir Vojvoda, Glorja Shllaku, Anita Amuli, Imeldi Sokoli, Muharrem Shkjau, Amila Lici, Jetmira Rraboshta.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit **Z.Oltion Luli**  
Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. *Pr/Vendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Qershor 2025”.*
2. *Pr/Vendim: “Për miratimin e listës së përfituesve dhe masën e subvencionimit të interesave të kredive për individë/familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët me kredi të lehtësuara nga shteti”.*
3. *Projektvendim: “Për një ndryshim në Buxhetin e Bashkisë miratuar me VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar”.*
4. *Pr/Vendim: “Për miratimin e kërkesës për transferimin të 89.65% të aksioneve të “Duhan Cigare” sh.a nga Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit në pronësi të Bashkisë Shkodër”.*

5. *Pr/Vendim: "Për përditësimin e VKK Rrethina nr.43, datë 20.10.2010 "Për miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën rrethina, inventarizimin dhe miratimin e kërkesës për transferim në pronësi të Bashkisë Shkodër".*
6. *Projektvendim: "Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri".*
7. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Kourumi i domosdoshëm është present në sallë, mbledhja deklarohet e hapur.

**Z.Luli** bën leximin e rendit të ditës dhe thotë se ka një kërkesë për një pikë shtesë në rendin e ditës: *Pr/Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Korrik 2025".*

Para se të vijohet me votimin e rendit të ditës, fjalën e merr **Z.Bjanku**, i cili shprehet: Përsa i takon procedurës së mbledhjes, është e disata herë që ne e theksojmë që sipas rregullores, mbledhja e rradhës së Këshillit Bashkiak zhvillohet në javën e fundit të çdo muaji, përveç dy javëve të muajit Gusht. Dhe mblidhet jo më pak, pra, së paku një herë në muaj dhe nuk kemi asnjë lloj argumenti dhe asnjë lloj shpjegimi pse kjo po përsëritet.

Nuk respektohet kjo lloj procedure dhe ndoshta është mirë që të vendoset një lloj rregulli tek kjo pjesë. Kjo nuk është thjesht për ne për pjesëmarrjen ose diçka tjetër, por besoj është e rëndësishme edhe për qytetarët, për transparencë për ata që dëshirojnë që ta ndjekin, për mediat, për planifikimet që bëhen.

Ai shton gjithashtu që komisionet janë duke dështuar, mbajtjet e mbledhjeve të komisioneve. Janë organe të këshillit që përcaktohen në ligjin e qeverisjes vendore dhe nuk janë organe vullnetare, janë të detyrueshme. Kjo gjë është shumë e rëndësishme përsa i përket vlefshmërisë së aktit juridik që nxjerr Bashkia. E thënë ndryshe, ne kalojmë akte pa kaluar fare në komisione dhe ka dhe raste që nuk mblidhen fare.

Pika e dytë që duhet të them është në lidhje me një propozim që kemi bërë për dy rregullore. Ne kemi qenë pjesë e komisioneve përkatëse, na është ngarkuar një detyrë, një detyrë që e kemi realizuar, e kemi propozuar. Bëhet fjalë për rregulloren për titujt e nderit dhe rregulloren për emërtesat e rrugëve.

Na është thënë edhe nga ana juaj që në mbledhjen, pra kur e kemi, do të merret mendimi i Drejtorisë Juridike. Edhe prapë se prapë po kalojnë shumë kohë dhe nuk përfshihet në rendin e ditës, që nuk e di pse është e njëjta gjë. Nuk kemi asnjë lloj shpjegimi, as për këtë.

Fjalën e merr **Znj.Pode**, e cila shprehet se lidhur me situatën e datës 8 Korrik që ndodhi në Shkodër, propozoj një minutë heshtje për të ndjerin Arben Anamali, Dëshmor i Atdheut që la jetën në krye të detyrës për të mbrojtur jetë njerëzore.

( Mbahet një minut heshtje në sallë )

Përgjigjet **Z.Luli** lidhur me atë çka tha Z.Bjanku, duke thënë se përsa i përket konstatimeve, nuk bëhen për herë të parë, janë konstatimet të cilat ne i kemi diskutuar dhe i kemi ndarë së bashku. Por duhet të keni parasysh diçka, se secili prej këshilltarëve ka edhe detyrat e veta dhe të drejtat e veta, dhe mosmbledhja e komisioneve nuk është një përgjegjësi, e cila në cilësinë e kryetarit më takon mua. Është përgjegjësi që i takon secilit prej këshilltarëve. E njëjta gjë vlen edhe për kryesinë, e cila në shumicën e rasteve është mbledhur, ndoshta me përjashtime të pakta kryesia nuk ka pasur korum për të marrë vendime. Por në kryesi janë diskutuar pjesa më e madhe e projektvendimeve, Kurse në lidhje me dy kërkesat që ju me të drejtë shtroni përsa i përket rregulloreve; nga ana juaj janë paraqitur dy rregullore një në emrin e komisionit, dhe një nga ana juaj dhe e zotit Anamali. E përveç kësaj, unë i kam kërkuar edhe zyrës juridike të Bashkisë Shkodër, pra që të sjellin një mendim dhe një propozim të vetin. Deri në këto momente, nuk kemi një dakordësi se cilën nga rregulloret do të kalojmë, atë rregullore e cila është propozuar në emër të grupit apo rregulloren që është propozuar nga ana juaj dhe zotit Anamali.

Unë kam deklaruar edhe herë të tjera që si fillim duhet të sqarojmë cila projekt rregullore është e vlefshme e juaja dhe Z.Anamali apo ajo e grupit tuaj të punës, pasi kemi dy variante.

**Z.Bjanku** shton se është e drejtë të paraqiten variante, diskutohen dhe miratohen në Këshill. Nuk e vendosi unë se cili nga variantet duhet të merret në konsideratë, por a mund të kemi një mendim nga drejtoria juridike.

Përgjigjet **Z.Luli**, duke thënë se nuk kemi akoma një mendim të tyrin, për më tepër nuk kemi present në sallë asnjë nga drejtoria.

Për më tepër , si anëtare e komisionin fjalën e merr **Znj.Gjekaj** e cila shprehet, se edhe ajo duhet të bashkohet me këtë problematikë.

Unë kam çuar edhe një email, thotë ajo para disa muajve dhe zyra juridike duhet të më kishte kthyer një përgjigje në lidhje me rastin, nuk kam asnjë përgjigje. Dhe dua të theksoj që nuk ka një mosmarrëveshje, pra ne nuk kemi dy rregullore, dy projekte rregullore, kemi një draft rregullore. Por nuk biem dakord si anëtarë të komisionit në lidhje me një nen të tij. Pra, ne një nen e mendojmë dhe e propozojmë në forma të ndryshme. Dhe duke u ndodhur në kushtin që flasim vetëm për një nen, është shumë e thjeshtë që drejtoria juridike të sjellë një këshillë.

Secili nga ne mund të propozoj mendimin e tij për nenin në fjalë, si unë po ashtu edhe Zoti Bjanku me Zotin Anamali, të cilët kanë një mendim tjetër për atë nen të rregullores.

Le ta propozojnë, ne do bëjmë interpretimet tona dhe kush të jetë më bindësi, do t'ia lëmë në dorë për votim anëtarëve të Këshillit. Por, shton ajo, është e papranueshme që një numër aq i madh kërkesash nga qytetarët në lidhje me këto rregullore të mbesin pezull e pa zgjidhje, vetëm sepse drejtoria juridike nuk paska vendos akoma se cilin variant të zgjedhë ndërkohë që është krejt e thjeshtë, pasi nuk flasim për dy draft rregullore, por vetëm një draft rregullore, për të cilën për gjitha pikat kemi rënë dakord si anëtarë të komisionit, vetëm për njërin nën jo. Për atë nen, secili nga ne merr përgjegjësinë për interpretim momentin që do vijë në Këshill.

Kështu që shpresoj shumë që përfaqësuesit e Drejtorisë Juridike pranë Bashkisë Shkodër të marrin masat të menjëhershme për të marrë vendimin edhe për të na kthyer përgjigje.

Hidhet në votim rendi i ditës së bashku me pikën shtesë të propozuar, ku rezultojnë **38** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Para se të vijohet me pikat e rendit të ditës kërkohet miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak datë, 25.06.2025.

Fjalën e merr përsëri **Z.Bjanku**, i cili thotë se në dijeninë e tij ka një projekt që lidhet me transkriptimin e procesverbalit, nga Bashki të Forta, e cila mundëson tashmë transkriptimin automatik të tij. Dhe nuk e kuptoj pse ne vazhdojmë të bëjmë një përmbledhje faktikisht, sepse ka shumë fjalë tonat që nuk gjejnë reflektim në procesverbal. Ndoshta mund të kemi një sqarim pse nuk po përdoret kjo mënyrë.

Përgjigjet **Z.Luli**, duke thënë se përsa i përket kërkesës që ju bëni, zoti Bjanku, kjo është në proces. Po testohet transkripti i mbledhjeve të Këshillit. Ka një problem që lidhet me diskutimet që bën secili prej individëve. Transkriptimi bëhet pa përcaktuar folësin dhe ky është një problem. Besoj që duhet të zgjidhet në një moment që do të regjistrohet zëri i gjithësecilit prej anëtarëve të Këshillit që diskutojnë, në mënyrë që të jetë lehtësisht e zbatueshme për sa i përket. zbardhjes së tij. Është provuar me mbledhje të tjera, por transkripton vetëm diskutimet pa përcaktuar se kush është folësi, kush është oponenti apo diçka tjetër. Ky është problemi që ka aktualisht sistemi. Besoj që do zgjidhet shumë shpejt. Është problemi i teknologjisë, jo i joni.

Hidhet në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar, ku rezultojnë **30** vota Pro **0** Kundër **6** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika e parë e rendit të ditës: *Pr/Vendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Qershor 2025”.*

**Znj.Pode** propozon që të hidhet në votim edhe Pr/Vendimi: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Korrik 2025”, pasi nuk kanë nevojë për relativim.

Atëherë hidhet në votim pika e parë: *Pr/Vendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Qershor 2025”*, ku rezultojnë **38** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Po ashtu votohet edhe *Pr/Vendimi: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Korrik 2025”*, ku rezultojnë **38** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika e dytë e rendit të ditës: *Pr/Vendim: “Për miratimin e listës së përfituesve dhe masën e subvencionimit të interesave të kredive për individë/familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët me kredi të lehtësuara nga shteti”.*

Relaton për këtë pikë **Znj. Kruja**, drejtoreshë e zyrës së Shërbimit Social dhe Strehimit, pranë Bashkisë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

**Z.Bjanku** kërkon të dijë pse ka kaq ngurim ose ka kaq pak aplikime, ndërkohë që situata në Bashkinë e Shkodrës , situata ekonomike dhe çiftet e reja, duket dhe konstatohet që është krejt tjetër në raport me numrin e pakët që ka për këto kredi. Pse është e tillë situata? Ndoshta mund t'i propozohet qoftë edhe Këshillit të Ministrave apo edhe Ministrisë përkatëse të Ekonomisë për të ndryshuar diçka, sepse kemi shumë pak aplikime, ndërkohë që nevojat janë shumë të mëdha.

Përgjigjet **Znj.Kruja**, e cila thotë se me atë që ne kemi konstatuar është sepse vlerat e shtëpive janë rritur. Këto i kemi përcjellë edhe pranë Ministrisë dhe kuotat e reja që sjellin janë me vlera të reja subvencionimit, kjo ka qenë arsyeja se edhe në momentin që ata përfitojnë, nuk arrijnë të lidhin një kontratë për të përfituar masën e kredisë. Edhe pse i kanë shtyrë afatin përtej gjashtë muajsh përsëri kanë arritur që e kanë e zënë dhe nuk janë tërhequr. Kur të hapen kuotat e reja, do të hapen me tarifa të reja që janë pak më favorizuese për ta. Por gjithmonë kuotat e tregut mbesin të larta.

Përsëri **Z.Bjanku**, atëherë pra i bie që edhe këto procedura që ne i miratojmë këtu, duhet medeomos të kalojnë te banka. Dhe pas bankës kalon tek kontrata me sipërmarrësit. Sa për qind e këtyre që kalojnë për miratim tek ne, rezultojnë që të kenë një kontratë të lidhur? Ndoshta edhe në këtë kuadër, mund të bëhet promovim? Të paktën qytetarët, të jenë mjaftueshëm të informuar për këtë. Mos ndoshta përveçse të publikohen në faqen e ëeb të Bashkisë Shkodër, ka nevojë për më tepër në këtë drejtim?

**Znj.Kruja**, përsëri janë ezauruar 63 me ato që ne kemi realizuar, që janë lidhë kontrata në këto vitet e fundit, domethënë janë shumë pak. Prandaj ne nuk kemi zeruar akoma njëqindëshin. Përtej asaj që kalojnë në Këshill, mbesin kuotat e pezulluara. Shpresojmë që me kuaot e reja, që janë më favorizuese të ketë rritje të numrit. Ne, shton ajo, përveç publikimit në faqen e ëeb dhe përmes qendrave tona komunitare bëhet edhe informimi në territory dhe me fushatë ndërgjegjësuese do bëjmë që të merret sa më tepër informacion, jo vetëm përmes faqes, sepse ndoshta nuk e njohin të gjithë. Do e mundohemi që të jetë edhe vizive, audiovizive, që ta ndjekin edhe më tepër. Megjithatë, se sa kuota do të ketë, edhe se sa do të përfitojnë nga këto, do e shohim në vazhdim.

Fjalën e merr **Z.I.Sokoli**, i cili shprehet se në fakt, diskutimi ka të bëjë me dokumentin që i paraprin listës apo procedurës për dhënien e kredive të buta, përsa i përket planit pesëvjeçar të strehimit social. Në në faqen e Bashkisë Shkodër nuk kemi asnjë proces. Procesi është komplet hermetik përsa i përket këtij planit pesëvjeçar të strehimit social. Nuk disponohet as në faqen e bashkisë. Ky dokument është dokumenti fillestar i politikës së strehimit social dhe pse jo, mund të themi, i programeve që mbart në vetvete ligji. Dhe në këtë pikë, ne nuk kemi asnjë informacion në lidhje me kuotat dhe si zhvillohen kuotat nga viti në vit.

Keni diçka për të na thënë përsa i përket këtij plani që është, mund të them, guri i themelit i politikës së strehimit social në Bashkimin e Shkodrës?

Përgjigjet **Znj.Kruja**, jemi në process të një draft plani që nuk është i miratuar, kështu që deri në

momentin që ta kemi të miratuar, do të procedojmë.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehen Pro.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **36** vota Pro **0** Kundër **1** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek tek pika e rradhës së rendit të ditës: *Projektvendim: "Për një ndryshim në Buxhetin e Bashkisë miratuar me VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar".*

Relaton për këtë pikë **Z.Mema**, drejtori i përgjithshëm i Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

**Znj.Shala**, merr fjalën dhe shprehet se duke parë që po kërkojmë për të marrë një fond prej rreth dyqind milionë lekësh për të bërë projekte. projekte infrastrukturë rrugore, objekte apo vende të tjera, në një kohë që ne kemi miratuar vazhdimisht fonde për projekte, unë kisha disa pyetje. Cilat janë detyrat dhe për çfarë paguhen punonjësit e drejtorisë së planifikimit dhe zhvillimit të territorit? Bashkia Shkodër ka një mijë e sa punonjës. A merren këta me projekte? A merren këta me propozime mbas nevojave? Në dijeninë time në strukturë ka inxhiniera, ka teknicienë. A thua duhet të paguhet përsëri ekstra taksa që të kemi gati projekte që ndoshta nesër edhe nuk miratohen kurrë, ose nuk shkojnë fare për miratim?

Përgjigjet për këtë në mënyrë të detajuar **Z.Mashi**, drejtor i zyrës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit në Bashkinë Shkodër duke thënë se punonjësit, në strukturë kanë detyrat e tyre funksionale, Përsa i përket pyetjes konkrete tuaj, a bëjnë projekte vetë drejtoria? Duhet të them se është vetë Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe vetë dispozitat ligjore që nuk lejojnë një gjë të tillë që punonjësit e administratës të mund të firmosin, pasi duhen të jenë persona të licensuar.

**Z.i.Sokoli**, shprehet se në fakt, ky instrument që ju keni përdor, është instrument i ngjashëm me një vendim që ne kemi kaluar në vitin 2024. Që është fond i kursyer nga Ministria e Ekonomisë , një fond prej 60 milionë lekë të reja, përsa i përket projektimit. E para, ne nuk e dimë se cili është produkti i këtyre lekëve sepse është e njëjta logjikë që është kërkuar në këshill që të kalohet një marrëveshje e tillë në mënyrë që ne të kemi gati të gjithë bazën teknike të projektimit përsa i përket thirrjeve të ndryshme. Dhe në dijeninë time nga ky 60 milionë lekësh, nuk ka asnjë produkt kryesor që është përdorur dhe që ka ndihmuar Bashkinë Shkodër në bazën e projektimit edhe bazën e projektimit teknik, pra për thirrje të hapura për donatorë apo në institucione publike. Cili është produkti që kemi pasur ne pas vitit 2024 në kuadër të gjashtëdhjetë milionëshit? Sepse në dijeninë time, ajo është një dështim dhe ne po pretendojmë përsëri një shtesë tjetër lekësh dhe nuk e dimë si duhet ta përdorim.

**Z.Mashi** përgjigjet, duke thënë se janë realizuar disa marrje angazhimi që kanë shkuar deri nivelet e prokurimit publik, por nuk janë lidhur për shumë arsye të ndryshme. Dhe kjo jo për fajin e Bashkisë Shkodër, Ndoshta specifikisht mund t'i tregoj edhe me raste, janë plane të detajuara vendore që janë në proces e sipër akoma.

**Znj.Nika** thotë se pa dashur të suportoje edhe drejtorin e planifikimit të territorit por mendon se po e ngatërrojmë pjesën e projekteve, më shumë i konsiderojnë si projekte lëndore sesa si projekte të cilat kanë nevojë për asistencë shumë të madhe teknike. Kështu që besoj që duhet të mos futemi fort në detaje, të cilat pastaj i japin informacion të gabuar publikut.

**Znj.Golemi** merr fjalën dhe shprehet se po kërkohet të miratohet një fond për këto projekte. A mund të dimë se kush do bëjë përcaktimin se cilat janë këto projekte që do kërkohen? Kush e përcakton grupin që do të bëjë këto projekte, sepse është një fond që do të nxirret për projekte. Janë nxjerrë disa pika, sheshet urbane, segmente rrugore, parqe e tjerë, janë të përgjithshme. Pra, kush e bën përcaktimin që të kërkohet një projekt për këtë, përderisa thuhet që këto projekte do të jenë gati për një fazë të dytë, kur dalin thirrja. Dhe kush do të jenë personat që do bëjnë këto projekte? Kush do t'i përzgjedhë këto?

Përgjigjet përsëri **Z.Mashi**; Thirrje mund të vijnë nga ministritë, nga ministritë e linjës, që mund të jenë fonde që të përcaktohen ose detajojnë fushën e përdorimit të këtyre projekteve. Dhe në momentin kur të jetë thirrja, atëherë do të bëhen detyrat e projektimit dhe do t'i ofrohet ose do të prokurohet ajo vlerë sipas fondit të investimit. Ideja është që të presim thirrjen dhe të lidhim investimin me projektin.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku Z.Ndou dhe Z.Sokoli shprehen pro, kurse Znj.Shala për sa më sipër shpehet kundër pr/aktit.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **29** vota Pro **9** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 4. të rendit të ditës: *Pr/Vendim: "Për miratimin e kërkesës për transferimin të 89.65% të aksioneve të "Duhan Cigare" sh.a nga Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit në pronësi të Bashkisë Shkodër".*

Relaton për këtë pikë Zv.Kryetari **Z.Preka**, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

**Znj.Shala** merr fjalën dhe thotë që duke qenë që ne po bëjmë ndryshim të destinacionit, normalisht mendoj që duhet të ishte bërë konsultim publik përpara. A janë pyetur pronarët për këtë? Sepse normalisht i takon pronarëve pronësia përpara se ti kalojë Bashkisë.

Sqaron **Z.Preka** duke thënë se nuk jemi në rastin e ndryshimit të fushës së përdorimit, por është thjesht një kalim pronësie të aksioneve të kompanisë. Nuk ka nevojë për dëgjuesë publike dhe as të pyetën pronarët, sepse nuk jemi në rastin e shitjes të kompanisë por po kalojnë aksionet nga Ministria tek Bashkia Shkodër.

**Z.Bjanku** përsëri shprehet se na u sqarua dhe në relacion thuhet që kjo është një shoqëri aksionere domethënë që ka një strukturë të caktuar dhe mendohet që më në fund, ndoshta Bashkia e Shkodrës do të marrë këtë objekt. Kërkojmë të dimë: A ka në një plan biznesit për këtë objekt pasi ne duhet ta kemi të qartë se për çfarë na shërben ajo sepse flasim për një ndërmarrje e cila ka qenë funksionale në një periudhë të caktuar dhe ka shumë njerëz që kanë punuar dikur aty. Pra, kjo është një situatë që duhet të sqarohet se çfarë do të bëjë bashkia me këtë subjekt. Për më tepër po flasim për zonën industriale, zona industriale për çdo lloj bashkie dhe për çdo lloj qyteti është shumë e

rëndësishme dhe është pjesë e planifikimit urban që ka. Bashkia duhet ta ketë shumë të qartë kur merr përsipër për të bërë këtë kërkesë për transferim të kësaj pronë. Prandaj kërkojmë një sqarim për këtë gjë, çka do të bëjë Bashkia me këtë objekt dhe me këtë sipërfaqe, që është shumë e madhe.

Përgjigjet **Z.Preka** duke thënë se me të drejtë mund të thoni se çfarë projektësh ka për zonë industriale. Kam përshtypjen që nuk mjafton të kesh një projekt. Objekti në fjalë nuk është funksional për momentin, ajo sh.a nuk funksionon në atë drejtim sikur ka qenë për prodhim. Si fillim duhet patjetër ta kemi ne dhe pastaj të mendojmë të bëjmë një plan biznesit.

Pastaj me anë të procedurave ligjore, mund të ndërtohen banesa sociale, mund të kenë projekte shumë të mira për qytetin dhe zhvillimin e zonës.

Në momentin që ta kemi si asset, do të vijmë në Këshill bashkiak dhe t'i themi qytetarëve gjithë projektin që kemi për atë zone, për atë sipërfaqe. Për më tepër për të mos e lemë të degradojë dhe të jenë problem për banorët e zonës.

Përsëri **Z.Bjanku**, për mendimin tim kjo është një mangësi shumë e madhe. Ne po shtojmë inventarin e pronave të Bashkisë Shkodër, duke mos e ditë se çfarë do të ndodhin mbrapa. Këto, përveçse janë pasuri, kërkojnë edhe një ide shumë e qartë sepse me to lindin edhe detyrime. Pra nuk është thjesht një pronë më shumë në asetet e Bashkisë.

Sqaron përsëri **Zv/Kryetari Preka**, duke thënë se edhe ju e dini që nuk mund të bësh projekt pa pasur pronën në rrallë të parë. Edhe për ndërtim banesash sociale por edhe për ndërtim të një industrie tjetër. Nuk mund të bësh asnjë plan, nuk mund të paraqitesh në asnjë institucion pa pasur çertifikatën e pronësisë. Dhe ne këtë po bëjmë. Po kërkojmë pronë, në mënyrë që të paraqesim projekte, kjo është e vërteta.

**Z.Kapcari**, pyet nëse janë verifikuar detyrimet që ka kjo shoqëri aksionere kundrejt OSHEE-së dhe UKSH-së? Sepse me ndjeninë time, thotë ai ka shumë detyrime. Kush do i paguajë ato? Bashkia apo ministria?

Përsëri **Z.Preka** përgjigjet se këto do të zgjidhen me anë të VKM-së, por në fund do t'i paguajë edhe Bashkia. Janë detyrime minimale në krahasim me vlerën që ka, vlerën financiare që ka.

**Znj.Golemi**, kjo sh.a ka patur një bilanc. A mund të dimë a ka detyrime të prapambetura?

**Z.Preka**, po ka një detyrim prej nëntë milionë e tetëqind mijë lekë të reja.

**Z.Sokoli** shprehet se pra vendimi nuk është i plotë, sepse nuk është paraqitur bilanci këtu. Duhet minimalisht, të kishte një audit të jashtëm financiar bashkëngjitur të këtij vendimi. Në mënyrë që me të shohim koston që ka kjo pronë që ne po e marrim. Është shumë e rëndësishme të themi që ajo zonë është zona industriale dhe në qoftë se e përdorni atë pronë për diçka tjetër, ju thyeni ligjin e planifikimit të territorit. Keni papërputhshmëri në përdorimet e tokës.

Sqaron përsëri **Zv/Kryetari Preka**, dihet që aty ka pas ndërhyrje pafundësisht, nuk është vënë dora. Është lënë ashtu si është lënë. Padyshim që ne nuk do ta përdorim në kundërshtim me ligjin. Nëse do ketë projekte, do bëhen kërkesat specifike për të ndryshuar aty ku është e nevojshme.

**Znj.Osja** thotë se po kërkohet nga kolegu Z.Bjanku asistencë teknike për një fushë, e cila nuk është marrë akoma në pronësi dhe nuk kërkon një asistencë teknike për projekte të cilat janë në planin e përgjithshëm të zhvillimit të territorit, e miratuar në 2015. Besoj që është e qartë të kuptohet se cilat janë investimet që nuk janë të realizuar në kohë, pse nuk janë të realizuar në kohë dhe çfarë detyrimesh i kemi qytetit dhe Shkodrës. Mendoj që sa më shumë përgjegjësi që të merrni, aq më mirë e bëni punën tuaj edhe atyre që përfaqësoni.

Replikon **Z.Bjanku** duke thënë se ne bëjmë oponentë që i shërben edhe Kryetarit të Bashkisë, i shërben Shkodrës, dhe të gjithëve në vlerësimin tonë.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku Z.Ndou dhe Z.Sokoli shprehen pro, kurse Znj.Shala shprehet kundër pr/aktit.

Ndërhyn **Znj Shkrela**, duke thënë se lidhur me zonën industriale duhet të kenë prioritet pronarët aty. Pasi ato nuk i pyet as qeveria e as Bashkia.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **25** vota Pro **9** Kundër **1** Abstenim. **Miratohet**

**Z.Bjanku** merr fjalën dhe thotë se për procedurë duhet të shohim mirë numrin e votave që kërkohet për tjetërsim prone.

Sqaron këtu **Z.Luli** duke thënë se nuk bëhet fjalë për marrje vendimi për tjetërsim prone, por për miratimin e kërkesës për këtë.

Vijohet me pikën tjetër të rendit të ditës: *Pr/Vendim: “Për përditësimin e VKK Rrethina nr.43, datë 20.10.2010 “Për miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën rrethina, inventarizimin dhe miratimin e kërkesës për transferim në pronësi të Bashkisë Shkodër”.*

Relaton përsëri Zv.Kryetari **Z.Preka**, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Pyetje dhe diskutime për këtë pikë nuk ka.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehen Pro.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **33** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e fundit të rendit të ditës: *Projektvendim: “Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri”.*

Kjo pikë nuk ka nevojë për relativitet prandaj kalohet direkt në votim, ku rezultojnë **34** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

*Kalohet në diskutime jashtë rendit të ditës.*

Fjalën e merr **Znj.Golemi**, e cila shprehet se në fakt, ne kemi dhe dy materiale të tjera për dijëni. Janë në lidhje me tavanet përfundimtare të programit të buxhetit afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Shkodër

Në kushtet kur kuadri makroekonomik dhe fiskal 26-28 mbetet i njëjtë si në fazën e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm, grupi i menaxhimit strategjik i mbledhjes së datës 18 korrik, në mbështetje të ligjit për financat, vendosi që për këtë fazë tavanet të jenë të njëjta.

Unë në fakt, thotë ajo, do të shtroj disa pyetje të cilat i kam shtruar me një kërkesë drejtuar kryetarit të bashkisë, dhe kam marrë një përgjigje me shumë vonesë, megjithëse afati ligjor është dhjetë ditë. Në fakt, përgjigja që unë mora është bërë nga njësia e auditimit të brendshëm dhe është firmosur nga nënkryetari zoti Alban Preka.

Për më tepër përgjigjet janë të cënuara, megjithëse e drejta e këshilltarëve është për të marrë informacion. Po i rishtoj pyetjet:

Kush janë anëtarët e grupit të menaxhimit strategjik? A ka një relacion për këtë mbledhje për të cilën ne na u soll informacioni? Çfarë është diskutuar dhe cilat janë përparësitë që ka vënë ky grup i menaxhimit strategjik? Cilat janë rrisqet dhe cilat janë mekanizmat që përdoren për realizimin e këtyre menaxhimeve? A munt ë kem një përgjigje?

Përgjigjet **Znj.Haxhi**, drejtoreshë e përgjithshme e menaxhimit financiar dhe buxhetit.

Në lidhje me si funksionon grupi i menaxhimit strategjik dhe nga çfarë përfaqësuesish janë, është ligji 10296/2001. Bashkia e Shkodrës që nga 2011 ka grup menaxhimi strategjik dhe bëhet me vendimin e parë që bëhet nga Kryetarit në janar. Anëtarët e grupit, kryetari i grupit të menaxhimit strategjik është vetë kryetari i bashkisë. Anëtarët janë gjithë nënkryetarë, por dhe drejtuesit e lartë, domethënë drejtorët. Në rastin konkret, sot janë drejtorët e përgjithshëm, janë dhe drejtuesit e institucioneve. Ekziston, është i përvitshëm, sot që flasim janë gati katërmbëdhjetë vjet që çdo vit bëhet ky grup i menaxhim strategjik. Dhe është vendimi i parë që bëhet sapa fillon viti kalendarik. Kurse për rastin konkret me të vërtetë janë bërë mbledhje me grupit strategjik. Është bërë te salla e OSBE-së, dhe është diskutuar në lidhje me tavanet.

Pyetja e parë është bërëka që nëse do kemi ndryshim të planit të të ardhurave.

Ndërkohë, transferta e kushtëzuar sektoriale mbetet në të njëjtët nivele, sepse është udhëzimi për këtë. Pikërisht ajo që thotë kuadri makroekonomik është pjesë e cituar nga udhëzimi i Ministrisë së Financave. Dhe pastaj është marrë vendimi nga grupi i menaxhimit strategjik që të mos lëvizë tavanin.

Për këtë ka edhe procesverbal, ka edhe listë që firmoset nga gjithë pjesëmarrësit. Kjo është procedurë e zakonshme.

**Znj.Golemi** kërkon të dijë nga zv.Kryetari Preka lidhur me përgjigjen që ajo ka marr shkresërisht, Pse s'ka marrë përgjigje, megjithëse u dha pas njëzet e një ditësh një përgjigje e cunguar. Ajo shton se është e drejta e Këshilltarit të marrë informacion. Ajo nuk ka marr informacion as për për auditin e brendshëm, por normalisht do vazhdoj kërkesat dhe hapat e mëtejshëm. As për menaxhimin strategjik, për grupin e menaxhimit strategjik, i cili edhe sot në mbledhje u tha që kishte bërë një mbledhje, nuk ka asnjë lloj informacioni. Për më tepër të gjitha sa kam kërkuar duhen të jenë të publikuara në faqen e Bashkisë sepse është detyrim ligjor. Dhe ju, jo vetëm që nuk i publikoni në faqe, por nuk na i jepni as pas kërkesës të dytë.

**Z.Preka**, patjetër që ajo përgjigje është trajtuar nga drejtoritë përkatëse, është dhënë informacioni në bazë të ligjit dhe ju është thënë që mund të vini tek drejtoria e Auditit dhe të keni cdo dokumentacion dhe informacion në dispozicionin tuaj.

Ndërhyt **Znj.Nika** duke thënë , se do ishte mirë që të bëhet rregull që për pyetjet që kanë lidhje me shifrat dhe që duhet të ketë akses në dokumentacion, të ketë një afat kohor nga drejtoria përkatëse për të kthyer përgjigje, që edhe mos i mërzisim njerëzit edhe ne mos të dukemi qesharakë dhe të mos kalojmë në debate të kota.

Fjalën e merr në vijim **Znj.Shllaku**, e cila shprehet se dëshiron të cek një temë shumë të ndjeshme, që na ka prekur të gjithëve, aq më shumë në qytetin e Shkodrës, po dhe banorët atje të Thethit. Është me të vërtetë e turpshme se si Kryetari i bashkisë, bashkë me administratën e tij u bë pjesë e propagandës së Kryeministrit Rama, që erdhi së bashku me shpurën e tij nga Tirana për të shkatërruar Thethin në kulmin e sezonit turistik, në vend që Kryetari i bashkisë, bashkë me administratën e tij të ishin në krahë të banorëve atje. Mos të harrojmë se atje është një plagë për komunitetin dhe duhet të na vijë turp të gjithëve që jemi bërë pjesë e saj. Së dyti, shton ajo dua të ndaj një shqetësim për Shkodrën. E themi shpesh që Shkodra, qyteti turistik, sezoni turistik ka shumë që po vijnë, po e vizitojnë atë, por është fatkeqësi se në çdo rrugë të qytetit të Shkodrës, duke filluar nga pedonalet, rrugët kryesore e duke shkuar deri te zonat periferike, koshat e plehnave janë plot me mbeturina.Nuk pastrohen në asnjë orar të ditës. Gjithashtu, edhe në pedonale është një ndotësi që të vjen turp.Mendoj që duhen të merren masa të menjëhershme për këtë, sepse është një përgjegjësi e administratës së Bashkisë.Po ashtu, me shumë rëndësi është edhe pjesa e këndeve të lojërave dhe hapësirat publike.Ka shumë shqetësime nga qytetarë, sidomos edhe nga nënat me fëmijë.Edhe ato pak kënde që janë, janë të dëmtuar. Është diskutuar shumë për palestrat e shkollave, kemi diskutu disa herë në Këshill bashkiak për çështjen e palestrave që të jenë të hapura dhe të jenë në dispozicion të aktiviteteve fizike të ndryshme për të rinjtë, por nuk është marrë asnjë masë dhe nuk kemi përgjigje as për këtë.

Përgjigjet **Zv.Kryetari Rudin Beka**, i cili thotë se e para është përse i përket pastërtisë nuk është e vëtetë që nuk kryhet pastrimi i koshave dhe larja e pedonaleve, madje frekuenca e pastrimit është rritur.Përse i përket lojërave dhe këndeve sportive, muajin që kaloi, ne i miratuam bashkë në Këshill edhe fondin për to. Kemi raste ku disa janë të amortizuara, por jo të gjitha.Po punohet në identifikimin e këndeve problematike që të ndërhyjmë me buxhetin që ju keni miratuar. Po mendohet për pjesën më të madhe të lagjeve dhe zonave të Bashkisë Shkodër, por edhe edhe për njësitë administrative. Nga ana tjetër, edhe për palestrat , po rikonceptohen dhe do të kenë kushte shumë të mira dhe standarde shumë të mira për sportin.

Për më shumë detaje dhe për punën që kryhet çdo ditë në terren , flet edhe **Z.Shabaj**, përgjegjës pranë Ndërrmarrjes së Shërbimeve publike.

Kurse në lidhje me ndërhyrjet në Theth, flet **Zv.Kryetari Preka**, i cili thotë se e kuptoj që është dhimbshme, por nuk mund të themi që është sulm politik, kur vetë ai aksion nuk ka pasur lidhje fare me politikën. Janë prishur ndërtime pa leje, sikur është konstatuar edhe nga ana juaj. Dhe sot vini këtu dhe thoni pse u bë aksioni për ti prish këto ndërtime. Sanksionet janë mbajtur shumë më përpara. Atë ditë ka qenë vetëm zbatimi, por duhet të dini që është zbatuar vetëm ligji dhe do kishte qenë më e dhimbshme pas një viti.

Fjalën e merr **Znj.Petani**, e cila shprehet se përsa i përket Shkodrës, Shkodra është shumë rregull. Mangësi ka normalisht, por s'mund të krahasohen me 4 vite më parë. Ka qenë rrumpallë, nuk ka pasur rrugë kurrë, as janë larë, asgjë. Unë personalisht jetoj në pedonale dhe nuk mundet të thotë askush që nuk lahet pedonalja. Kurse përsa i përket lojërave të fëmijëve, është e vërtetë që nuk ka shumë lojëra, por përderisa ne e kemi bërë projektin, e kemi miratuar atë projekt, nuk mund të themi që nuk është bërë asgjë në këtë drejtim. Shkoda e dimë mirë, sepse çdo gjë po bëhet avsh-avash. Pra, Shkodra po riparohet defektin e tridhjetë vjetëve. Edhe përsa i përket Thethit, bashkohem me zv.Kryetarin, që është e dhimbshme, por ligji duhet zbatuar. Ato qytetarë që janë atje janë të nderuar dhe të respektuar dhe mos harroni që deri dje nuk ka patur rrugë për atje. Pse nuk e thoni këtë? Është bërë rruga dhe i është dhënë zë atij vendi. Prandaj nuk duhet të bëjmë shoë politik.

**Z.Behri**, shprehet se është vera e tretë që Bashkia ka në menaxhim Velipojën dhe investimet e premtuara nuk janë bërë pothuajse fare dhe është e disata herë që kërkon të paktën mirëmbajtje, të paktën të rrugëve që kanë nevojë urgjente për ndërhyrje. Dhe nuk e kuptoj më mungesën e vëmendjes së Bashkisë për Velipojën. Ai shton gjithashtu se Velipoja duhet të ketë më shumë promovim, sidomos me koncerte apo aktivitete të ndryshme, sepse ka mungesë turistash si asnjëherë tjetër dhe kjo ndoshta duke mos i dhënë përparësi Velipojës. Po flitet sot për larjen e pedonaleve të Shkodrës, duhet që edhe pedonalja e Velipojës të lahet të paktën dy herë në muaj që është krejt e mundshme, mund ta bëjnë ujësjellësi dhe përsa i përket sheshit do të kërkoja vëmendje më të madhe për pastërtinë e sheshit. Po ashtu, shatërvani në qendër që herë ndizet e herë jo.

Përgjigjet për këtë **Z.Beka**, që thotë se e kemi diskutuar këtë çështje dhe kemi bërë një takim edhe me ujësjellësin, sepse ky është një problem me të. Dhe presim shumë shpejt që ata ta rregullojnë, sepse ne kemi rënë dakord që do bëjmë një farë sistemimi. Po ashtu edhe për rrugët kemi marrë masat tona, është çështje kohe.

**Z. Sokoli** : Në fakt, duhet të filloj tek çështjet që u preken pak. Përsa i përket mbetjeve, për sa kohë ne nuk duam të kalojmë në subjektivizëm dhe për sa kohë nuk kemi një evidencë monitorimi, të menaxhimit të mbetjeve këtu, se ç'janë përmirësu dhe nuk kemi indikator, ne flasim në ajër. Zotëria me të drejtë tha që unë zbatoj kontratën, po zbatimi i kontratës është nuk është i mjaftueshëm. Ne e dimë që s'është i mjaftueshëm vetëm zbatimi i kontratës. Duhet të kalojmë përtej kësaj, në qoftë se duam të kemi një efekt apo një diskutim për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve. Sepse është bazike për menaxhimin e turizmit në këtë rast. Turizmi kërkon patjetër një menaxhim të mirë të mbetjeve. Nuk e kemi të faktuar me fakte, për sa kohë që s'e kemi të faktuar me fakte, nuk duhet të flasim nga hera e parë. Përsa i përket diskutimit që bëni nënkryetari, përsa i përket projektit, luajmë bashkë. Ju keni investime të reja në sheshe dhe këtu po përmendni sheshin Vëllezërit Frashëri, që keni investuar kohët e fundit. Dhe aty nuk ka asgjë në lidhje me fëmijët, ka vetëm beton dhe pllaka. Pra, cili është vizioni juaj ku një shesh që i përgjigjet gjashtë pallateve, shtatë pallateve dhe nuk ka asnjë gjë në lidhje me fëmijët? Është zero, është kthyer në një parkim. Edhe kjo mirë që është parkim, se parkimi duhet, por nuk ka asnjë gjë, s'ka as gjelbërim, as gjë as për shtetasat të tjera si p.sh për pleqtë.

Pra, këto janë vetëm premtime që ju bëni herë pas here për përmirësimin e shesheve dhe hapësirave publike për fëmijët dhe përsa i përket aksionit të përmendur lart e poshtë, i për rrugët automobilistike etj., që ka ndërmarrë qeveria. Shumë mirë, okej, qeveria ka vendosur të hyjë në një aksion të fortë për të ndaluar paligjshmërinë. Por ju e dini të gjithë, është projekti i rrugës Baçallëkut, që akoma nuk ka një leje ndërtimi të zbardhur. Janë dhënë dy këste lekësh, janë depozituar dy këste lekësh dhe nuk ka një projekt të miratuar në Këshillin e Kombëtar të Territorit. Nuk ka një leje të zbardhur. Çfarë ndërhyrje duhet të bëjnë instancat e shtetit ndërmjet njëra-tjetrës që të bllokojnë në fakt këtë paligjshmëri? Sepse shumë kollaj ne i trajtojmë, por banorëve I bie mbi kokë, duke prishë investimin e jetës së tyre.

Unë I kam bërë shkresa institucioneve të tjera dhe oponenca që ka bërë instituti i ndërtimit është e tmerrshme. Keni mungesë të analizës hidroteknike dhe hidraulike të projektit, që është kryesore për sa i përket urës dhe ju duhet të jeni në dijeni për këtë pjesë dhe duhet të çoni zërin për këtë pjesë në mënyrë që ky investim mos shkojë në dëm. Është më mirë një investim i vonuar se sa një investim i shkuar dëm.

Dhe specifikisht, instituti i ndërtimit thotë që kushtet e sigurisë në rrugë daljet nëntëdhjetë gradë në rrugë me një rrugë me katër korsi janë të palejuara. Pra, ky projekt që në projektim ka probleme teknike të mëdha dhe ju duhet të ishit në dijeni për këtë, aq më tepër që jeni pa leje ndërtimi. Në rastin ju duhet të gjykoni të tjerët pse kanë ndërtuar pa leje të tjerë, po në fakt në vetvete edhe vetë kemi një aferë që vetë shteti është pa leje. Kurse përsa i përket projektit të Zdrales, ju keni patur një vizion për zonën e Zdrales. Shumë mirë. Para disa kohësh, kur e prezantuat me anë të Kryeministrit, me anë të diskutimit të tij në Shkodër, është një zonë që mirëpritet investimi publik në këtë rast. Po në fakt, kemi një projekt që është i kundërt me vizionin që keni pas ju përsa i përket zonës Zdrales. Tani kush është vizioni juaj dhe cilin vizion mbështetni? A mbështesni vizionin që keni pas apo vizionin e ri?

**Z.Preka**, kemi vetëm dy vite në drejtim të Bashkisë Shkodër dhe po na kërkohet të bëjmë çdo gjë, si me magji. Përsa i përket projektit, patjetër që është, por nuk është trombetuar me kohë. Projektimi dhe përsa i përket mënyrës së zhvillimit dhe vendosjes në zonat e caktuara, në lagjet e caktuara të këndeve të lojërave, është bërë një analizë e parë se ku janë problemat më të mëdha që kemi. Është kërkuar fondi më i madh ndonjëherë për këtë gjë dhe keni ardhur me plan konkret dhe kjo është miratuar. Dhe ju e dini shumë mirë që kjo don kohën e vet. Por s'mund të thoni që nuk ka një plan, të thuash që nuk ka një vizion ndryshe, s'është e vërtetë.

**Z.Bjanku**, flet në lidhje me thirrjen e hapur që ka bërë Bashkia Shkodër për vende të lira pune. atëherë kam një pyetje thotë ai, se ma kanë bërë disa nga studentët e mi në fakt. Janë shumë studentë të cilët kanë aplikuar në një thirrje të fundit që ka bërë Bashkia e Shkodrës për rekrutim stafi. Duke qenë se ne miratojmë numrin e administratës dhe të ndërmarrjeve që ka në varësi Bashkia, a mund të dimë ku janë këto vende, me çfarë ligji do bëhet ku rekrutim, a janë nëpunës civil apo janë janë thjesht me kontratë, apo a ka ndonjë lloj argumentimi ligjor mbi cilin ligj dhe me çfarë procedure do ndiqet? Sepse thirrjet e fundit për rekrutim në administratën e Bashkisë vlerësohet që mund të jenë rreth treqind aplikime, pra të gjithë këta njëerëz pretendojnë dhe krijojnë pritshmëri që diçka do të bëhet.

Përgjigjet **Z.Beka** duke thënë se përgjithësisht ne kemi mungesë dhe dëshirë të madhe për arkitektë dhe inxhinierë. Kjo është edhe një nga pikat kryesore që ne si Bashki kemi nevojë. Nga ana tjetër,

po shohim edhe strukturimin në vende të ndryshme dhe mundësisë për të parë njerëz që janë realisht të aftë për të punuar në Bashkinë Shkodër dhe për tu bërë pjesë e stafit tonë.

Për më tepër sqaron **Znj.Dama**, drejtoreshë e përgjithshme Juridike dhe e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Shkodër duke thënë se thirrja që kemi bërë është një ftesë e hapur për shfaqjen e interesit nga qytetarët e Shkodrës për të kontribuar në Bashkinë Shkodër, sigurisht që për punësime ndiqet ligji e legjislacioni në fuqi për nënpunësit civil dhe për ata me kod pune, çdo thirrje për punësim shpallen me vendet vakante sipas legjislacionit. Ne jemi në pikën ku po njihemi me interesin që kanë qytetarët në bazë të formimit të tyre profesional për tu bërë pjesë e Bashkisë Shkodër, por kjo është vetëm në kuadër të identifikimit të personave që kanë interes për fusha të veçanta, siç është arkitektura, inxhinieria e të tjerë, por secili prej këtyre do t'i nënshtrohet procedurave ligjore, siç operojmë zakonisht, atëherë kjo është vetëm një sondazh që përdor Bashkia Shkodër. Dhe vazhdojmë në të njëjtën trajtë, pra është vetëm shfaqje e interesit dhe gjithmonë Bashkia Shkodër ka qenë e hapur për shfaqje interes si nëpërmjet kërkesave në protokoll, edhe nëpërmjet takimeve me drejtorët përkatës apo Burimet njerëzore që takojnë çdo ditë. Këtë herë ka qenë një thirrje publike nga Kryetari i bashkisë, që çdokush që e ndjen veten që mund të ofrojë kontributin e tij profesional në Bashkinë Shkodër, mund të paraqesë CV e tij dhe interesin e tij për tu bërë pjesë e administratës dhe sigurisht do t'i nënshtrohet procedurave ligjore në fuqi.

**Zj.Petani** merr fjalën përsëri dhe shprehet se përse i përket Hyrjes së Shkodrës, po bëhet diçka shumë e bukur, do bëhet sin e vendet Europiane, Thjesht duhet të kemi pak durim, se çdo gjë do kohën e vet. Ajo shton se dëshiron të falenderojë Drejtorin e Policisë bashkiake sepse po bëni një punë shumë të vështirë përse i përket qytetit të Shkodrës. Të paktën te lagjja ku banjo unë, gjithmonë ka qenë një tmerr i vërtetë. Ka qenë lagje shumë problematike dhe sot kemi gjetur rehati.

**Znj.Shllaku** shprehet se me keqardhje thotë se përsëri Bashkia Shkodër me Kryetarin e saj u bë pjesë në një zamadhie që me thanë të drejtën, nuk di se si me e shpreh. Nuk e kuptoj se si munden me u largu në këto raste, të përjashtohen dy aktorë të mrekullueshëm të trupës së teatrit Migjeni. Dhe kjo me një shkresë që është aq qesharake saqë dhe unë që ndoshta nuk marr vesh nga ligji kuptoj që nuk ka një arsyetim ligjor. Të hiqen nga puna dy artistë të mrekullueshëm, gjë që ka nxitur një reaksion qytetar mbarëkombëtar për ata të dy, është e turpshme. Kështu që ju lutem shumë, reflektoni dhe reflektoni mirë sepse është e turpshme që të largohen dy aktorë të mrekullueshëm për arsye politike.

Fjalën e merr **Znj.Gjekaj**, e cila thotë se duhet të sqaroj paraprakisht që salla e Këshillit Bashkiak normalisht shërben edhe për problematika që janë më të gjalla, duke cekur kështu edhe një ndër shtyllat kryesore që është e drejta e pronësisë. Problematika e Thethit, ajo çfarë ndodhi në atje, na kujtoi dhe na bëri të reflektojmë që ligji i detyron institucionet publike të bashkërendojnë punën me njëra-tjetrën. Ka ardhur koha që pronarëve t'i kthejmë tokat bujqësore, duke i dhënë mundësi pronarëve ta zhvillojnë atë.

Duke respektuar kështu edhe një ndër parimet kryesore, që është parimi i sigurisë juridike. Ka shumë qytetarë të cilët kanë aplikuar, po prapë edhe pse ato disponojnë të gjithë dokumentacionin, të gjitha hartat, planin e riveimit ku vërtetohet që janë posedues ligjorë, ku vërtetohet që janë trashëgimtarë ligjorë të paraardhësve të tyre lidhur me tokat bujqësore nuk i është hapur rrugë. Dhe të gjitha kërkesat e tyre kanë mbetur të fjetura, dhe automatikisht ç'na sjell kjo, sjell një ngërç

të madh, ku sot ai që e posedon një pronësi nuk është në gjendje ta zhvillojë pronësinë e tij, pra nuk mund të ushtrojë të drejtën e pronësisë së tij. Prandaj ka ardhur koha që malësorëve, që janë trashëgimtarë ligjorë t'ia kthejmë tokat e tyre, duke i dhënë mundësinë që ta zhvillojnë dhe ta gëzojnë tokën e tyre.

**Znj.Shkrela**, shprehet se në fakt nuk dëshironte të ndalej tek çështja, pasi e kam thënë edhe herë të tjera që Bashkia nën administrimin e saj po e "shkrin" teatrin. Në fakt, një institucion si teatri me një histori shumë vjeçare, me titullin "Nderi i Kombit" të shkrihet është e turpshme dhe këtë e paçi në qafë ju që e keni votuar, sepse më rrallë të parë përpara se të jeni ju anëtarë Këshilli të Partisë Socialiste apo të Benet Becit në këtë rast, jeni qytetarë të Shkodrës. Jeni qytetarë që besoj pjesa më e madhe e juaja keni shkuar në teatër, dhe keni parë çfarë prodhimtarish ka patur ai teatër. E dini shumë mirë historikun e atij teatri dhe e dini shumë mirë se teatri Migjeni në fakt është një simbol ndër vite e ndër shekuj i qytetit të Shkodrës, që ju me një karton e keni shkrirë, e paçi në qafë, kurse përse i përket dy aktorëve, nuk kam nevojë ti mbroj unë sepse në fakt i mbron diploma që kanë, i mbron mbështetja e madhe e qytetarëve dhe në fund do ti mbrojë vula e gjykatës në përfundim të procesit gjyqësor. Kurse në lidhje me shkeljet dhe abuzimet me taksat e qytetarëve, fillimisht do duhej të verifikonit drejtoreshën e kulturës, zonjën Saras Smaja, e cila është paligjshëmrisht aty sepse, nuk i është nënshtruar konkursit. Për ju që e dini, por bani sikur s'e dini, drejtoresha e kulturës është pushuar nga teatri Migjeni për shkak se nuk ka pranuar të luaj role. Pra merrte rrogën këtu, por nuk pranonte rolet në teatrin Migjeni. Pjesa tjetër për kryetarin e Bashkisë, zotin Benet Beci, sepse ai ishte në fund që vuri firmën e shkarkimit, përveçse nuk vjen, dhe sot po shoh se edhe zonja Smaja nuk ka ardhë sepse janë strukur nga frika e përballjes. Dhe në fakt, Kryetari i Bashkisë, përpara se të flasë për mbrojtjen e taksave të qytetarëve shkodranë, është dashur fillimisht të vinte këtu dhe të fliste për abuzimet që ai vetë ka bërë, jo vetëm me taksat e qytetarëve shkodranë por me taksat e të gjithë shqiptarëve, kur ka qenë drejtor i KESH-it dhe kur ka qenë drejtor i FSHZH-së. Mos harroni se Benet Beci, kryetari i Bashkisë dhe i deleguari politik i Partisë Socialiste, është i pandehur, në SPAK sepse ka abuzuar me taksat tona. Prandaj më përpara të vijë këtu dhe të japin llogari për tenderat korruptiv që ka bërë me taksat e shqiptarëve, jo vetëm të shkodranëve.

Përse i përket Thethit, ku keni qenë ju Bashkia përpara? Ata banorë kanë investu qindra mijëra euro, përse i latë me investu, sepse ato ishin të viteve të fundit nuk ishin kullat qindra vjeçare, jo. Për më tepër nuk shkuat njëherë aty, sepse edhe ju i përfaqësoni ata sepse janë banorë të Bashkisë Shkodër.

**Zv.Kryetari Preka** përgjigjet duke thënë se kjo nuk është nivel bisede që e meritojnë qytetarët e Shkodrës. Ju kuptoj për Thethin shton ai, por nuk mund të pranoj atë ç'ka u tha për pagesa për mbetjet e inerteve nga vetë banorët atje. Akt konstatimet, procedimet penale janë bërë me kohë. Janë ndjekur procedura dhe mund t'i verifikoni. Që të nesërmen kanë qenë të gjithë punonjësit e Bashkisë Shkodër, grupe të disa drejtorive për të pastruar territorin, prandaj nëse dikush i ka kërkuar para është krejtësisht abusive dhe jemi gati të verifikojmë çdo rast.

**Z.I.Sokoli** thotë se regjistrim fillestar pasurie në Theth nuk ka, është zero. Pastaj juve e keni menaxhuar shumë keq këtë situatë sepse dy vitet e fundit janë ndërtuar 80% e atyre ndërtimeve. Dhe ju e dini shumë mirë këtë. Për më tepër ndërhyrja u krye në mes të sezonit turistik, në një kohë që flisni për turizëm dhe kjo është e turpshme.

Ndërhyn **Znj.Shkrela** e cila thotë se të paktën ndërhyrja duhej bërë në shtator ose tetor, të lireshin me punu që të shlynin sadopak kreditë e marra. Dhe vini tani këtu me justifikime sepse nuk mundeni ti dilni për zot banorëve të atij vendi.

Fjalën e merr **Z. Shkjaui** i cili shprehet se kur u prishën banesat e ligjshme, 40 lokale në hyrje të Shkodrës, para zgjedhjeve, që ishin me dokumentacion të rregullt kolegët këshilltarë nuk reagueshan dhe nuk bënë këtë zhurmë. Por tani që humbën zgjedhjet, po tregohen hipokritë dhe me dy standarte duke e përdorur politikisht situatën e Thethit.

**Znj.Petani** shprehet se përse i përket ndërhyrjes policore në Theth që përmendi Znj.Shkrela nuk duhet të harrojmë se “policia e tyre” ka vrarë njerëzit në rrugë. Kurse Policia në Theth ka shkuar për të mbrojtur ata njerëz, kështu që mos i ngatërrojnë punët. Përse i përket teatrit , nuk është në tagrin tonë si Këshilltarë , që këtë problem ta zgjidhim ne.

*Pyetje e diskutime të tjera nuk ka.*

*Kryetari e Këshillit **Z.Luli** e deklaroi mbledhjen të mbyllur.*

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër të datës 04.08.2025. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 17 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

**V.o:** Ky procesverbal do miratohet nga anëtarët e Këshillit në mbledhjen e radhës së Këshillit bashkiak.

**Sekretar**

**Sabina DANAJ**

Zbardhi Pr/verbalin:

**Irma Sulishti**

